

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-148/11**

**Prishtinë,  
29 nëntor 2012**

Në çështjen juridike të:

**S.B.,**  
përfaqësuar nga **S.B.**

***Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë***

**D.M.**

***Pala ankuese***

kundër

**R.M.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/85/2010 (lënda është e regjistruar

në AKP me numrin. KPA 10112), të datës 2 shtator 2010, pas shqyrtimit të mbajtur më 29 nëntor 2012, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

- 1- Hedhet si e palejueshme ankesa e D.M. për shkak të mungesës së interesit juridik.
- 2- Pranohet ankesa e S.B., i përfaqësuar nga S.B..
- 3- Anullohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/85/2010 (lidhur me lëndën të regjistruar në AKP me numrin KPA 10112), i datës 2 shtator 2010, për shkak të mungesës së juridiksionit.
- 4- Hedhet kërkesa e R.M. Nr. KPA10112, që ka të bëjë me ngastrën 517 për shkak se bie jashtë juridiksionit të KKPK-ës.
- 5- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) duhet të paguhet nga pala përgjegjëse në ankesë R.M. në Buxhetin e Kosovës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij nën kërcënimit të përmbartimit të detyrueshëm.

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Më 24 gusht 2006, R.M. paraqiti një kërkesë pranë Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një pasurie që ndodhet në Lipjan, Halaq i Madh, ngastra nr. 517, tokë e punueshme e klasit 4, me një sipërfaqe prej 71 ari dhe 36 m<sup>2</sup>. Përveç kësaj, ai kërkoi kompensim për shfrytëzim të paautorizuar. Kërkesa është regjistruar si KPA 10112.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai dorëzoi në AKP dokumentet vijuese:

- Fletën Poseduese nr. 20 të Komunës së Lipjanit, zona kadastrale Halaq i Madh, e datës 7 shkurt 2003, e cila vërteton se ngastra e kërkuar ka qenë e regjistruar në emër të V.M. dhe J.(J.)M.;
- Çertifikatën e Vdekjes (Nr 203-3-1599/04-8-1674) të J.M. (data e vdekjes 10 nëntor 1984), e lëshuar nga Komuna e Lipjanit (Republika e Serbisë) më 29 korrik 2004;

- Letërnjoftimi, lëshuar më 2 gusht 1993 në Lipjan (Republika e Serbisë);
- Çertifikatën e Vdekjes (Nr 203-3-1594/04-8-1673) të V.M. (data e vdekjes 10 nëntor 1981) lëshuar më 29 korrik 2004 nga Komuna e Lipjanit (Republika e Serbisë) dhe
- Çertifikata e Lindjes e paraqitësit të kërkesës R.M., lëshuar më 19 korrik 2007 nga Komuna e Lipjanit (Republika e Serbisë), që vërteton se J.(J.)M. dhe V.M. janë prindërit e R.M..

Më 19 qershor 2007, zyrtarët e AKP-së shkuan te ngastra dhe vendosën lajmërimin që tregojnë se prona ishte objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditësh. Prona u gjet e uzurpuar nga pala përgjegjëse në kërkesë S.B. dhe ai ishte i pranishëm gjatë kryerjes së njoftimit.

Më 22 qershor 2009 S.B. në emër të babait të tij S.B. si palë përgjegjëse në kërkesë, vizitoi zyrën e AKP-së dhe deklaroi se ata i kishin blerë ngastrat kadastrale 515, 520, 521 dhe 552 nga D.M., përderisa në ngastrën e kontestuar nr. 517, me lejen e personit të njëjtë si bartës i së drejtës pronësore ata (familja B.) kanë ndërtuar një shtëpi. Për më tepër, ai deklaroi se ndërmjet tyre ishte arritur një marrëveshje gojore për blerjen e menjëhershme të pronës së kontestuar dhe se e drejta e bartësit të së drejtës pronësore ishte realizuar.

Për ta mbështetur përgjigjen e tij, ai dorëzoi në AKP dokumentet vijuese:

- Kontratën e Shitëblerjes të lidhur më 10 maj 2006 dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Lipjanit më 30 Qershor 2006 (VR.nr. 2101/2006);
- Çertifikatën e Tatimit në Pronë nr. 432-2-725, të lëshuar më 15 maj 2006 nga Departamenti për Buxhet dhe Financa i Komunës së Lipjanit;
- Çertifikatën e Tatimit nr. 02/2-333, të lëshuar më 12 maj 2006 nga Drejtorati për Tatimin Pronësor të Komunës së Lipjanit, dhe
- Letërnjoftimin e UNMIK-ut, lëshuar më 21 shtator 2004.

AKP ka verifikuar pozitivisht Kontratën e shitëblerjes VR.nr. 2101/2006 të datës 30 qershor 2006.

Më 2 korrik 2009, AKP i dërgoi paraqitësit të kërkesës përgjigjen e palës përgjegjëse në kërkesë.

Më 21 korrik 2009, paraqitësi i kërkesës dorëzoi në AKP përgjigjen e tij me shkrim. Ai pohoi se pronare e ngastrave nr. 516 dhe nr. 517 ishte e ëma e tij e ndjerë J.(J.)M.; se pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë nuk janë të vërteta dhe pas vdekjes së nënës së tij, ai është pronar i këtyre ngastrave. Ai (paraqitësi i kërkesës) kurrë nuk kishte biseduar me blerësin/palën përgjegjëse në kërkesë të pretenduar, ai as nuk i ka shitur ngastrat dhe as nuk e di se kush është blerësi i pretenduar. Ai kërkon dëbimin e uzurpuesit.

Më 4 shkurt 2010, pala përgjegjëse në kërkesë (S.B.) dorëzoi një deklaratë të shkruar me dorë. Ai theksoi se i biri i tij në kërkesën e dorëzuar kishte deklaruar gabimisht se *“ne jemi duke shfrytëzuar ngastrën nr.517”*. Për më tepër, në deklaratën e tij ai shtoi se në realitet ata shfrytëzojnë ngastrat 516, 520, 521 dhe 522 dhe se ai posedon dokumentet lidhur me këto ngastra.

Për të mbështetur deklaratën e vet, ai paraqiti këto dokumente:

- Dokumentet e njëjta që janë dorëzuar në AKP nga i biri i tij, gjegjësisht, Fleta Poseduese nr. 20, Kontrata e Blerjes Nr. 2101/2006, Çertifikata e Tatimit nr. 02/2-333 dhe Çertifikata e Tatimit Pronësor nr. 432-2-725;
- Kopja e Marrëveshjes për Hapjen e Llogarisë Individuale dhe Kartelës, dhe
- Letërnjoftimi i UNMIK-ut, lëshuar më 8 prill 2009.

Më 22 mars 2010, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së kontaktoi me z. S.B. dhe e pyeti atë lidhur me mospërputhjen ndërmjet përgjigjes së tij në emër të babait të vet/palës përgjegjëse në kërkesë dhe deklaratës së dorëzuar nga vet pala përgjegjëse në kërkesë. Në përgjigjen e tij, S.B. theksoi se kur e kishte dhënë përgjigjen ai nuk kishte qenë i sigurt rreth numrit të ngastrës dhe përfundimisht deklaroi se ai nuk e konteston ngastrën e kërkuar nr. 517.

Më 16 korrik 2010, AKP kontaktoi palën përgjegjëse në kërkesë dhe e pyeti nëse ai dëshiron ta tërheq përgjigjen e tij pasi që ai deklaroi se nuk pretendon të drejtë ligjore mbi ngastrën e kërkuar dhe ai kishte dhënë përgjigjen gabimisht. Ai theksoi se dëshiron ta tërheq përgjigjen dhe premtoi se do ta vizitojë Zyrën Regjionale të AKP-së në Prishtinë që ta plotësojë formularin e tërheqjes. Atij i është dhënë një afat prej 30 dhe i është thënë se nëse nuk e tërheq përgjigjen brenda afatit, kërkesa do të procedohet si e kontestuar.

Pala përgjegjëse në kërkesë nuk është përgjigjur dhe nuk i ka tërhequr pretendimet e veta; prandaj Agjencia e procedoi kërkesën si të kontestuar.

Me vendimin KKPK/D/A/85/2010 të 2 shtatorit 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) vendosi se paraqitësi i kërkesës kishte vërtetuar se J.M. ishte pronare e 1/1 të pronës së kontestuar dhe urdhëroi që paraqitësi i kërkesës R.M. ka të drejtë në posedimin e pronës së cekur, se pala përgjegjëse në kërkesë nëse ka, dhe cilido person tjetër që e ka pronën nën uzurpim ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e dërgimit të urdhrorit dhe nëse pala përgjegjëse në kërkesë apo ndonjë person tjetër nuk e përfill këtë urdhër për lirimin e pronës së kontestuar brenda afatit të cekur, ata do të dëbohen nga prona. KKPK hodhi poshtë kërkesën për kompensim të humbjes së shfrytëzimit për shkak të mungesës së kompetencës.

Vendimi iu dërgua palës përgjegjëse në kërkesë më 15 gusht 2011.

Më 18 gusht 2011, D.M. paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Supreme kundër vendimit të lartcekur të KKKPK-së. Ai konsideron se vendimi është marrë me anë të zbatimit të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale në fuqi. Ai në ankesën e tij deklaroi se ngastra, shtëpia si dhe tri ngastra janë blerë nga i ati i tij dhe se i ati i palës përgjegjëse në ankesë V.M. iu ka shitur atyre 12 ari. Ai ka jetuar në këto prona pa ndonjë ndërhyrje të ndonjë personi. Pala ankuese thotë se ia ka shitur tokën S.B..

Më 5 shtator 2011 S.B. (që përfaqëson S.B.) paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës Supreme kundër vendimit të lartcekur, i cili, sipas tij, ngërthente shkelje esenciale dhe zbatim të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale në fuqi dhe është bazuar në gjendje faktike jo të plotë. Ai e kundërshton vendimin sepse paraqitësi i kërkesës është konsideruar gabimisht si bartës i së drejtës pronësore, ndërsa pronari faktik i ngastrës së kontestuar ka qenë xhaxhai i tij, D.M., bazuar në transferimin që kishte ndodhur para 50 (pesëdhjetë) viteve dhe ngastra e kontestuar ishte shfrytëzuar nga ai dhe jo nga pala përgjegjëse në ankesë. Ai gjithashtu theksoi se i ati i D.M. kishte ngritur themelet e objektit të familjes, të cilën e kishin shfrytëzuar deri në vitin 1999 kur ishte djegur dhe ata ishin larguar nga fshati. Sipas z. B., kur D.M. posedonte dhe shfrytëzonte ngastrën e cekur, pala përgjegjëse në ankesë nuk e kishte kontestuar asnjëherë të drejtën e tij pronësore por këtë e bëri kur kuptoi se S.B. kishte hyrë në marrëdhënie kontraktuale lidhur me ngastrën e kontestuar nr. 517, për të cilën ai ende nuk e ka paguar çmimin e blerjes dhe kjo do t'i paguhet atij kur D.M. do ta dëshmojë të drejtën e tij pronësore mbi ngastrën e cekur.

Gjithashtu, në ankesën e tij pala ankuese pohoi se pas kërkesës së tyre drejtuar atij, D.M. u paraqit para AKP-së dhe dha deklaratën e vet lidhur me pronën e kontestuar. Pala ankuese thekson faktin se ata e kishin kontaktuar D.M. dhe kishin marrë miratimin e tij për ta rindërtuar shtëpinë në ngastrën e kontestuar dhe po ashtu pasi kishin pyetur njerëzit tjerë që jetonin afër dhe kishin marrë përgjigjen se prona i përkiste D.M., ata filluan me ndërtimin e shtëpisë, ndërsa për ngastrat tjera ishte lidhur kontrata e blerjes ndërmjet S.B. dhe D.M.. E njëjta kontratë e blerjes është vërtetuar në Gjykatën Komonale në Lipjan.

Para lidhjes së kontratës së cekur me D.M., temë e diskutimeve para kontratës ishte gjithashtu ngastra nr. 517, por pas konsultimit me një avokat kjo ngastër ishte lënë jashtë kontratës.

Në fund, ai theksoi se konflikti/kontesti për të drejtën pronësore mbi ngastrën e kontestuar është ndërmjet D.M. dhe palës përgjegjëse në ankesë R.M. dhe jo ndërmjet S.B. dhe palës përgjegjëse në ankesë.

Pala ankuese kërkoi nga Gjykata Supreme që ta shfuqizoj dhe anuloj vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/85/2010 të datës 2 shtator 2010, dhe më pas bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar në tërësi të merret vendim mbi (mos) njohjen e së drejtës pronësore të palës përgjegjëse në ankesë.

Më 10 janar 2012 Gjykata Supreme lëshoi një urdhër dhe kërkoi që pala ankuese D.M. ta informojë Gjykatën rreth adresës së tij të tanishme, të sqarojë pse nuk i është përgjigjur njoftimit të kërkesës më 19 qershor 2007, ta informojë Gjykatën nëse e tërë ngastra 517 i ishte shitur babait të tij apo vetëm 12 ari, nëse kontrata e shitjes është bërë në formë të shkruar dhe nëse është vërtetuar. Nga pala ankuese po ashtu është kërkuar t'i jep adresat e dëshmitarëve që dëshiron të pyeten.

Gjykata po ashtu kërkoi nga pala përgjegjëse në ankesë R.M. të përgjigjet në pretendimin se ngastra është shitur para pesëdhjetë vitesh (rreth viti 1960) babait të D.M..

Urdhri nuk i është dërguar D.M. sepse sipas informatave nga AKP, më 1 mars 2012 ai e kishte ndryshuar adresën e tij dhe nuk jetonte më në Graçanicë. Gjykata kërkoi që personi të kontaktohet me telefon dhe u vërtetua se adresa e tij e tashme është në Serbi, ku edhe i është dërguar urdhri.

Më 26 prill 2012 u përgjigj pala ankuese D.M.. Lidhur me njoftimin e datës 19 qershor 2007 ai shpjegoi se ai kurrë nuk kishte pranuar ndonjë njoftim, prandaj nuk ka dhënë përgjigje. Ai cek se i ati i tij kishte blerë vetëm 12 ari të ngastrës 517, ku ndërtuan shtëpinë dhe ku kanë jetuar deri në vitin 1999. Kontrata ishte e formës verbale. Përveç tjerash, ai përshkruan se ka jetuar në këtë ngastër për 50 vite, kur ishte duke ndërtuar shtëpinë e vet R. i kishte premtuar se do t'ia transferonte këto 12 ari në emrin e tij, por ai këtë nuk e ka bërë. Pala ankuese kërkoi nga paraqitësi i kërkesës që ta shesin tërë ngastrën 517, që përfshin këta 12 ari pasi që e tërë ngastra ishte ende në emër të babait të R., por paraqitësi i kërkesës u përgjigj se ai nuk dëshiron ta shes fushën e vet, por se ai (D.) mund t'i shes 12 ari të vetat nëse dëshiron. Ata kishin një marrëveshje që R. do t'i transferonte këto 12 ari në emër të S.B. por ai nuk e kishte bërë këtë.

Me datë 15 Qershor 2012 Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi një urdhër dhe i kishte kërkuar palës përgjegjëse në ankesë R.M. të përgjigjej në pohimet e D.M..

Me datë 5 nëntor 2012 R.M. kishte dërguar një letër ku shpjegonte se ngastra 517 (12 ari të saj) ishte shitur nga V.M. babai i ndjerë I.M., por toka nuk është paguar kurrë në tërësi, ato sipas gjuhës së palës përgjegjëse në ankesë "vetëm kontrata interne". Këto kontrata asnjëherë nuk ishin vërtetuar nga Gjykata Komunale. Më tutje ai pohon se kishte fletën poseduese të lëshuar nga Komuna për ngastrën 517. Ai gjithashtu shpjegon se

ai (R.M.) kishte informuar dëshmitarin I.I. se ai nuk duhej ta tjetërsonte pronën të cilën ai (R.M.) e posedon dhe të cilën ai e kishte trashëguar prej babait të tijë V.M..

### ***Arsyetimi ligjor:***

#### **Ankesa e D.M.:**

Ankesa e D.M. është e palejueshme për shkak të mungesës së interes ligjor në paraqitjen e ankesës kundër vendimit të KKPK-së lidhur me ngastrën e kontestuar. Kjo palë ankuese pretendon se pronën e tij ia ka shitur një personi të tretë – palës ankuese S.B., prandaj ai më nuk pretendon se është pronar i ngastrës 517 (12 ari të kësaj ngastre), por pronar është një person tjetër – i lartcekuri z. B.. Kjo do të thotë se ai, D.M., nuk ka interes ligjor për ta kundërshtuar vendimin e kontestuar të KKPK-së. Ekzistenca e interes ligjor është një parakusht absolut pozitiv procedural për lejueshmërinë e një ankesë në procedurë civile –neni 196 në lidhje me nenin 186.3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, që është e zbatueshme pranë Gjykatës Supreme në procedurën ankimore kundër vendimeve të AKP-së (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50). Ligji përcakton se një ankesë është e palejueshme nëse personi që e ka paraqitur nuk ka interes ligjor.

Kushti i nevojshëm për pasjen e interesit ligjor qëndron gjithandej në procedurën civile dhe vlen për çdo palë – argumentimi sipas nenit 2. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Ligji përcakton se një palë duhet të ketë interes ligjor në kërkesë dhe veprimet tjera procedurale që mund të kryhen në procedurë.

Rrjedhimisht, ky ankues nuk ka interes ligjor në procedurën e tanishme dhe ankesa e tij duhet të hidhet poshtë si e palejueshme.

Mungesa e interesit juridik e bën të panevojshme elaborimin nëse kjo ankesë është e pranueshme/e papranueshme për arsye se D.M. nuk ka marrë pjesë në procedurë pranë shkallës së parë.

#### **Ankesa e S.B., i përfaqësuar nga S.B.:**

Ankesa e S.B., i përfaqësuar nga S.B. është e pranueshme dhe e lejueshme. Ankesa është paraqitur kundër një vendimi të KKPK-së, nga një palë në procedurë brenda periudhës prej 30 ditësh, pas njoftimit për vendimin, sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (më tej Rregullorja 2006 apo Rregullorja).

#### **Interesi juridik i S.B., i përfaqësuar nga S.B. që të jetë palë në procedurën e tanishme:**

Gjykata e konsideron të domosdoshme të elaborojë rreth interesit ligjor të këtij ankuesi në këtë lëndë sepse gjatë tërë procedurës ai jep (personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij) deklarata të ndryshme dhe kundërthënëse lidhur me interesin e tij në këtë kontest. Në procedurën para instancës së parë ai fillimisht pretendoi të drejtat lidhur me ngastrën 517, pastaj ai shpjegoi se ai nuk kishte pretenduar të drejta mbi këtë ngastër, por njëkohësisht thoshte se kishte ndërtuar një shtëpi në ngastrën e njëjtë. Përveç kësaj, kur u ftua nga AKP që ta sqarojë qëndrimin e tij apo t'i tërheq pretendimet e veta, ai nuk e bëri këtë. Më pas, ai paraqiti një ankesë kundër vendimit ku përveç pretendimeve tjera të veta ai thotë se ky kontest nuk është në mes tij dhe paraqitësit të kërkesës, por ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe palës tjetër ankuese. Pavarësisht këtyre pohimeve ngatërruese dhe kundërthënëse, Gjykata pranon se kjo palë ankuese në fakt kërkon të drejta lidhur me ngastrën 517 sepse ka ndërtuar një shtëpi në të dhe prandaj për Gjykatën është e qartë se palët legjitime (ato me interes material juridik në kuptim të nenit 2.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore) në këtë kontest juridik janë paraqitësi i kërkesës R.M. dhe pala përgjegjëse në kërkesë S.B., i cili tani *de facto* posedon tokën pasi që ka ndërtuar shtëpi në të.

Sidoqoftë, është një pengesë procedurale për vendosjen në këtë ankesë:

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ri posedim të pronës në paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë private, por gjithashtu edhe se ai ose ajo nuk ka mundur t'i ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave të lidhura direkt ose që janë rezultat i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.

Duke bazuar në gjendjen faktike të konstatuar nga deklarata e paraqitësit të kërkesës se posedimi i pronës ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur 1998/1999 mbetet e pajustificueshme. Ai shpjegon se në të kaluarën, para luftës babai i tij V.M. “i shiti” këtë pronë xhaxhait të tij I.M., por prona s’ ishte paguar kurrë në tërësi. Megjithatë nuk është kontestuese se sipas kësaj marrëveshje jo formale babai i paraqitësit të kërkesës V.M. nuk e kishte zënë dhe nuk e kishte shfrytëzuar tokën., posedimi i tokës, zotërimi fizik i ngastrës (jo e drejta pronësore) ishte transferuar në personin tjetër – “blerësin” e pretenduar në marrëveshjen jo formale dhe kjo kishte ndodhur shumë më herët se lufta, prandaj ishte një proces tërësisht që nuk ndërlidhet dhe as që nuk rezulton nga ky konflikt. Pa marrë parasysh se çfarë efekti ligjor ka kjo “marrëveshje jo formale” – me gjasë kurfare, *de facto* babai i paraqitësit të kërkesës humbi posedimin mbi këtë tokë shumë më përpara se konflikti i armatosur. Prandaj, në procedurën para AKP-ës dhe Kolegjit të Apelit të AKP-ës të Gjykatës Supreme (argumentimi i bazuar në Nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50) nuk mund të kërkohet



riposedimi. Cilido kontest i zakonshëm ose kërkesë për kompensim në të holla duhet të gjejë zgjidhje mbrenda jurisdiksionit të gjykatave të rregullta.

Mbi bazën e kësaj Gjykata nuk duhet të shqyrtoj në meritat e ankesës së S.B..

Duke pasur parasysh se kërkesa e R.M. është jashtë jurisdiksionit të AKP-ës, andaj vendimi i ankimuar duhet të anulohet për shkak të mungesës së jurisdiksionit dhe se kërkesa duhet të hedhet.

### ***Shpenzimet e procedurës:***

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

-Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës së D.M. (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30

-Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës së S.B., përfaqësuar nga S.B. (neni 10.21 dhe 10.15 dhe 10.1 i UA 2008/2): € 30

-Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (10.21 dhe 10.1 i UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përllogaritet të jetë € 7136: € 50.

Këto tarifa gjyqësore duhet të paguhen nga paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë, i cili ka paraqitur kërkesën e palejueshme jashtë jurisdiksionit të AKP-ës. Ato duhet të paguhen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dërgimit të këtij aktgjykimi. Neni 47.3 parasheh se që në rast se pala nuk i paguan këto shpenzime mbrenda afatit, pala duhet të paguaj gjobë deri në 50% e shumës së taksës. Nëse pala nuk paguan shpenzimet në afatin e dhënë, do të zbatohet përmbarim i detyrueshëm.

***Këshillë juridike:***

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i prerë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**